



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MONITORIMIT
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE TË DREJTËSISË DHE MONITORIMIT TË
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË
SEKTORI I MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË NË FUSHËN PENALE

Nr. 1289/2 Prot.

Tiranë, më 03.04.2026

Lënda: Përcillet për ndjekje dhe zbatim Urdhri nr. 186, datë 31.03.2026 i Ministrit të Drejtësisë.

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS
Rr. "Jordan Misja", Tiranë

Në zbatim të pikës 2, të urdhërit nr. 186, datë 31.03.2026 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e modelit të planit individual të trajtimit për të dënuarit për vepra penale të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm", bashkëlidhur ju përcjellim për ndjekje dhe zbatim një kopje të këtij urdhri.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Geron Ibrahim





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 1289/prot

Tiranë, më 31.03. 2026

URDHËR

Nr. 186, datë 31 / 03 / 2026

“PËR
MIRATIMIN E MODELIT TË PLANIT INDIVIDUAL TË TRAJTIMIT PËR TË
DËNUARIT PËR VEPRA PENALE TË RADIKALIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË
DHUNSHËM”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 23, pika 7, të ligjit nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”, i ndryshuar, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Planit Individual të Trajtimit për të dënuarit për vepra penale të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm” bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës për zbatimin e këtij urdhri dhe Drejtoria e Përgjithshme e Monitorimit për ndjekjen e tij.
3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Toni Gogu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS
DEGA TERRITORIALE TIRANË

PLANI INDIVIDUAL I TRAJTIMIT

I. Hyrje

Emri dhe mbiemri i të mbikqyrurit: _____
Datëlindja dhe vendlindja: _____
Adresa e të mbikqyrurit: _____
Vepra/veprat penale e(të) kryer(a): “ _____ ” – neni
_____ i K. Penal
Numri i vendimit gjyqësor: Nr. _____ Vendimi, datë _____ të Gjykatës
së _____,
marrë formë të prerë më _____
Dënimi alternativ i dhënë nga Pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe
gjykata: vënia në provë (Neni 59 K. Penal)
Periudha e provës: _____ (____) vjet
Data e fillimit të mbikëqyrjes: _____
Data e mbarimit të mbikëqyrjes: _____

Emri dhe mbiemri i specialistit të Shërbimit të Provës së caktuar: _____

Qëllimi i Planit Individual të Trajtimit:

Krijimi i një plani trajtimi për individët që kanë kryer vepra penale në fushën e radikalizimit, ekstremizmit të dhunshëm apo terrorizmit është një proces që kërkon një qasje të integruar, të mbështetur nga praktikat më të mira në fushën e rehabilitimit dhe deradikalizimit.

Ky plan është i personalizuar, i bazuar në nevojat dhe rrethanat e individëve të përfshirë si dhe të fokusohet në ripërtëritjen e integritit psikologjik, social e moral të tyre.

Plani Individual i Trajtimit zhvillohet dhe zbatohet nga një ekip multidisiplinar, përfshirë psikologë, sociolog, edukatorë, punonjës social dhe ekspertë të fushës ligjore, në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe OJQ të specializuara në rehabilitimin dhe deradikalizimin.

Specialisti i Shërbimit të Provës mbështet dhe ndihmon personin nën mbikëqyrje gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes, në përshtatje me nevojat e saj, me qëllim shmangien e rrezikut të kryerjes së veprave të reja penale, riintegrimin në shoqëri, punësimin ose për normalizimin e marrëdhënieve me familjarët e saj, kur është e nevojshme.

II. Detyrimet gjatë periudhës së provës për personin nën mbikëqyrje:

- Shërbimi i Provës mbikëqyr ekzekutimin e dënimeve alternative ndaj personave nën mbikëqyrje në zbatim të vendimeve gjyqësore dhe urdhrit të ekzekutimit të prokurorit si dhe e informon personin nën mbikëqyrje mbi detyrimin e saj për të mbajtur kontakte me Shërbimin gjatë zbatimit të dënimit.
- Kur për arsye objektive, personi nën mbikëqyrje nuk mund të jetë i pranishëm në njërin prej takimeve, Ajo njofton paraprakisht specialistin e Shërbimit të Provës. Në rast se njoftimi nuk është i mundur, Ajo paraqitet pranë Shërbimit të Provës brenda tre ditëve nga përfundimi i pengesës dhe justifikon me dokumente mungesën e saj.
- Personi nën mbikëqyrje paraqet të dhëna me shkrim mbi arsyet objektive të mungesës, të cilat përfshihen në dosjen e saj personale.
- Specialisti i Shërbimit të Provës i caktuar verifikon arsyet e parashtuara dhe kur çmon që arsyet nuk justifikojnë mungesën, i jep personin nën mbikëqyrje një njoftim me shkrim ku i ribën të ditur pasojat e mospërmbushjes së detyrimeve dhe përmend datën e takimit të ardhshëm.
- Kur shihet që pas dy njoftimeve i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin, specialisti i Shërbimit të Provës i caktuar njofton drejtorin e degës territoriale të Shërbimit të Provës, i cili njofton brenda dy ditëve prokurorin.
- Detyrimet e personit nën mbikëqyrje në rast të ndryshimit të vendbanimit:
- Personi nën mbikëqyrje është i detyruar të njoftojë me shkrim dhe të marrë pëlqimin nga specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës për ndryshimin e vendbanimit apo vendqëndrimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda dhe jashtë vendit duke paraqitur dokumentacionin përkatës. Shërbimi i Provës jep ose refuzon në mënyrë të arsyetuar dhënien e pëlqimit pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës.
- Në raste urgjente, njoftimi për marrjen e pëlqimit, si dhe dhënia ose refuzimi i pëlqimit nga Shërbimi i Provës mund të bëhet edhe nëpërmjet telefonit ose postës elektronike. Në çdo rast personi nën mbikëqyrje dërgon me shkrim brenda 3 ditëve adresën e vendit ku do të qëndrojë dhe dokumentacionin përkatës që vërteton ndryshimin e vendbanimit, vendqëndrimit, qendrës së punës apo lëvizjen e kryer brenda vendit.
- Në rastin e dënimit me qëndrim në shtëpi, procedurat për ndryshimin e vendbanimit apo të vendqëndrimit rregullohen sipas përcaktimeve të bëra nga legjislacioni në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale.
- Nëse vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i personit ndodhet në një zonë jashtë kompetencës tokësore të degës territoriale të Shërbimit të Provës të ngarkuar fillimisht me mbikëqyrjen, kjo e fundit i dërgon degës territoriale të Shërbimit të Provës, në kompetencën tokësore të së cilës gjendet vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i personit nën mbikëqyrje, dosjen personale të shërbimit të provës.
- Specialisti përgjegjës për mbikëqyrjen njofton për ndryshimin e vendbanimit, vendqëndrimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit organet vendore të Policisë së Shtetit dhe prokurorin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit brenda tre ditëve.

- Kur gjykata në vendimin e saj ka caktuar një ose më shumë nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal, Shërbimi i Provës inkurajon dhe mbështet të dënuarin në përmbushjen e detyrimeve dhe verifikon përmbushjen e tyre.
- Për këtë qëllim, Shërbimi i Provës identifikon dhe lidh marrëveshje me institucionet lokale që mund të mbështesin përmbushjen e një apo më shumë detyrimeve të vendosura nga gjykata, siç janë Policia e Shtetit, qendrat e arsimit apo trajnimit, qendrat e punës, institucionet mjekësore apo OJF-të që ofrojnë programe rehabilitimi.
- Kur gjykata, sipas nenit 60 pika 1 të Kodit Penal, ka caktuar për të dënuarin detyrimin për të ushtruar një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim ose formim profesional, Shërbimi i Provës merr masat për vendosjen e të dënuarit në formën e përshtatshme të veprimtarisë profesionale apo arsimit/formimit profesional.
- Për këtë qëllim, punonjësi i Shërbimit të Provës identifikon qendrat arsimore dhe institucionet e kualifikimit profesional në nivel lokal që organizojnë kurse të tilla.
- Specialisti i Shërbimit të Provës i caktuar, kontrollon periodikisht nëse personi nën mbikëqyrje i ndjek kurset e arsimit apo kualifikimit.
- Nëse vendimi i gjykatës nuk specifikon llojin e veprimtarisë që do të ndiqet nga personi nën mbikëqyrje, Shërbimi i Provës përcakton llojin e aktivitetit dhe mënyrën e realizimit të tij. Kur gjykata, sipas nenit 60 pika 2 dhe 3 të Kodit Penal, ka caktuar për personi nën mbikëqyrje detyrimin të paguajë pensionet familjare apo të riparojë dëmin civil të shkaktuar, Shërbimi i Provës, gjatë kontaktit të parë, kërkon informacion mbi vendbanimin, mbi situatën dhe detyrimet financiare, vendin e punës dhe kohëzgjatjen e kontratës së punësimit dhe, kur është rasti, informacion mbi personat në ngarkim të tij. Shërbimi i Provës i shpjegon personit nën mbikëqyrje që Ajo duhet të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata dhe identifikon bashkë me të mënyrën dhe kohën e duhur të përmbushjes së detyrimeve financiare.
- Shërbimi i Provës kontrollon rregullisht nëse personi nën mbikëqyrje i përmbush detyrimet e vendosura nga gjykata dhe i dokumenton rezultatet e kontrollit.
- Kur gjykata ka caktuar për të dënuarin detyrimet e parashikuara në nenin 60, pikat 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 ose 12, të Kodit Penal, Shërbimi i Provës bashkëpunon ngushtësisht me institucionet lokale apo entet e tjera publike apo private që mund të asistojnë në mbikëqyrjen e ekzekutimit të detyrimeve.
- Brenda 3 ditëve nga kontakti i parë, Shërbimi i Provës i dërgon Policisë së Shtetit ose çdo organizatë tjetër apo institucioni që mund të asistojë mbikëqyrjen, informacion mbi personin nën mbikëqyrje, duke kërkuar që, në rast mospërmbushjeje të detyrimit, të njoftohet menjëherë.
- Kur është e nevojshme, Shërbimi i Provës bën vizita pa lajmërim paraprak në banesë ose në vendin e qëndrimit të personit nën mbikëqyrje për të siguruar mbikëqyrjen efektive të detyrimeve nga ana e saj. Nëpërmjet këtyre vizitave, Shërbimi i Provës mbledh edhe faktet, si dhe bashkëpunon me familjen e të personit nën mbikëqyrje me qëllim asistimin e saj në përmbushjen e detyrimeve të vendosura.
- Detyrimi konsiderohet i papërmbushur kur, pas një paralajmërimi me shkrim, Shërbimi i Provës konstaton që personi nën mbikëqyrje rishkel detyrimet e caktuara.

- Kur gjykata, sipas nenit 60 pika 11 e Kodit Penal, ka caktuar për personin nën mbikëqyrje detyrimin e mjekimit ose rehabilitimit në një institucion shëndetësor ose të nënshtrimit në një program trajtimi, mjekësor ose rehabilitues, Shërbimi i Provës identifikon, fillimisht, në nivel lokal, brenda 10 ditëve nga kontakti i parë, qendrën e përshtatshme për përmbushjen e këtij detyrimi. Kjo qendër mund të jetë shëndetësore, organizatë, institucion apo ekspert që realizojnë programe rehabilitimi për substancat narkotike, alkoolin apo lloje të tjera programesh rehabilitimi.
- Me qëllim lehtësimin e përmbushjes së detyrimeve, Shërbimi i Provës lidh marrëveshje me qendrat mjekësore, institucionet, organizatat dhe specialistët për rregullimin e procedurave konkrete të bashkëpunimit.
- Detyrimi i parashikuar në nenin 60, paragrafi I pika 11, të Kodit Penal konsiderohet i papërmbushur kur i dënuari në provë: në mënyrë të paarsyeshme, refuzon përfshirjen në një program trajtimi; në mënyrë të pajustificuar, ndërpret programin e trajtimit; refuzon t'u nënshtrohet testeve për konsumin e substancave.

III. Masat dhe çdo detyrim tjetër të vendosur nga gjykata:

Me vendimin penal Nr. _____ Vendimi, datë _____ të Gjykatës së Shkallës së Parë _____, marrë formë të prerë më _____, në ngarkim të shtetasit _____, ndër të tjera është vendosur:

- Deklarimin fajtor të shtetasës _____ për kryerjen e veprës penale të " _____ " - parashikuar nga neni _____ i Kodit Penal, dhe dënimin e saj përfundimisht me 4 (katër) vjet burgim.
- Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim duke e vënë të dënuarën _____ në provë për një periudhë kohe prej _____ vjet, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale si dhe të mbajë kontakte të rregullta me Zyrën e Shërbimit të Provës ku ka vendbanimin e saj.
- Të mbajë kontakte me Degën Territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë për përmbushjen e detyrave të caktuara nga gjykata dhe të njoftojë atë në rast ndryshimi të vendbanimit të qendrës së punës apo të daljeve jashtë shtetit.
- Në _____ aplikim _____ të _____ nenit _____

IV. Historik i rastit:

[në këtë sesion duhet të paraqitet një historik i jetës personale të të mbikëqyrurit; edukimi; punësimi; përbërja familjare dhe lloji i marrëdhënieve me ta; të dhëna mbi përfshirjen në praktikimin e fesë - arsyt shtytëse; të dhëna mbi personalitetin; mbi qëndrimet pro/a sociale; udhëtimi në zonat e konfliktit; ngjarje të rëndësishme të ndodhura atje; apo çdo informacion tjetër i gjykuar i nevojshëm përgjatë trajtimit.]

PËRMBLEDHJE E OBJEKTIVAVE

V. Vlerësimi i Riskut dhe Faktorët mbrojtës:

V.1 Niveli i Riskut sipas dimensionit:

Nr.	Dimensioni i Riskut:	NIVELI I RISKUT		
		i ulët	i mesëm	i lartë
1.	Cënueshmëritë kontekstuale			
2.	Faktorët psikologjikë dhe ideologjikë			
3.	Përfshirja sociale dhe kontakti ndërgrupor			
4.	Historiku i dhunës dhe kriminalitetit			
5.	Stili njohës dhe rregullimi emocional			
6.	<i>Niveli i përgjithshëm i Riskut</i>			

V.2 Faktorët kryesor të Riskut (sipas SVR):

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____

V.3 Faktorët mbrojtës (sipas SVR):

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____

V.4 Metodatat dhe qëllimet e përcaktuara për ndërhyrje:*[pasqyrë e faktorëve të rrezikut, nevojave kriminojgene, detyrimeve të vendosura nga gjykata]*

No.	Faktorët kryesor të Riskut/ Objektivat për trajtim	Mënyra e ndërhyrjes	Aktorët mbështetës	Afati
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				

VI. Data, vendi dhe frekuenca e takimeve midis punonjësit të Shërbimit të Provës dhe të mbikqyrurit gjatë periudhës së mbikëqyrjes:

Frekuenca e takimit me të mbikqyrurin është caktuar të jetë _____ nga ora 08.00-16.30 pranë ambienteve të Shërbimit të Provës apo ambienteve të banimit të të mbikqyrurit.

Kur ta shohë të arsyeshme, Shërbimi i Provës do të mbikëqyrë në çdo ambient ku i mbikqyruri mund të ndodhet si në atë të shtëpisë, punës, etj.

Vlen të dihet se takimet do të jenë të lajmëruara dhe të palajmëruara.

VI.1 Monitorimi dhe vlerësimi

Vlerësimi i progresit: Monitorimi i përparimit të individit dhe për të identifikuar nevoja të reja.

Ndryshime në Planin Individual të Trajtimit: Përshtatja e planit në bazë të rezultateve të vlerësimit dhe nevojave të individit.

Vlerësimi i progresit të Planit Individual i Trajtimit do të kryhet në bazë të instrumentit të dhënë në Shtojcën I.

Ndryshimet që vlerësohen të realizohen duhet të pasqyrohen sipas Anekseve të përdorura nga Shërbimi i Provës.

Data e rishikimit: _____.

I/E mbikqyruri/a është njohur me përmbajtjen e Plani Individual të Trajtimit dhe kupton bashkëpunimin në përmbushjen e detyrimeve të tij.

Një kopje e Plani Individual të Trajtimit, e plotësuar dhe e nënshkruar, i dorëzohet të mbikqyrurit.

Në rastet kur e mbikqyrura është i mitur, gjithashtu një kopje e Plani Individual të Trajtimit, e plotësuar dhe e nënshkruar, i dorëzohet mbrojtësit të tij/saj.

Data dhe vendi i nënshkrimit të Plani Individual të Trajtimit:

_____, pranë Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë

Personi nën mbikqyrje

Specialisti mbikqyrës

Miratoi:

DREJTORI

SHTOJCA 1:**Vlerësim Follow Up mbi ecurinë e Planit Individual të Trajtimit**

[ky vlerësim do të kryhet çdo vit nga specialisti mbikqyrës dhe në rast se vlerësohet nevoja për ndryshim të metodave të ndërhyrjes, në bashkëpunim me të mbikqyrurin]

Nr.	Nevojat rehabilituese të trajtuara	NIVELI I SUKSESIT			Shënime
		LARTË	MESËM	ULËT	
Rezultate të përgjithshme:					
Konkluzione për vijimësinë:					

Data: . . .

Specialisti mbikqyrës:

**Konfirmoi:
DREJTORI**
